



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:068647

Datë: 12.11.2024

Numri i dokumentit: 06438625

P.nr.97/20

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.65/24 të datës 08.11.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit K.Sh nga fsh...-Shtërpcë dhe të dëmtuarit E. H nga fsh...-Kaçanik, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.404-12/20 të dt. 03.06.2020, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 12.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.65/24 e datës 08.11.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit K.Sh nga fsh...-Shtërpcë dhe të dëmtuarit E. H nga fsh...-Kaçanik.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.404-12/20 e dt. 03.06.2020, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit K.(A...) Sh. nga fsh...-Shtërpcë, i lindur me dt..., me nr.personal: ..., për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.404-12/20 të dt. 03.06.2020, të pandehurin K.Sh nga fsh....-Shtërpcë, e ka akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.11.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si P.nr.97/20 , të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 08.11.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit te kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.65/24, në mes palëve në procedurë, dhe ate në mes të pandehurit K.Sh nga fsh....-Shtërpcë dhe të dëmtuarit E. H. nga fsh...-Kaçanik.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
P.nr.97/20 datë 12.11.2024

Gjyqtarja
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.